

# KREMTIET

ΤΟ ΓΝΕΩΝΙΟΝ ΤΟ ΘΟΥ



## **8 TË SHTATORIT**

### Të Lerit e Zonjës e Shë' Mëri

**Ant. I**

Kujtò, o i Madh'in'Zot, Davidhin e gjithë butësin e' Tij.

Për parkalesitë.... Lëvdi...nani...

**Ant. II**

Bëri bë in'Zot Davidhit mbi të vërtetën, e do të mbanjë ben e'Tij.

Shpëtona,o i Biri i Perëndis, i famasëshëm ndër shejtrat, neve çë të këndojojm. Alilua.

Lëvdi... nani...o i vetëmi Bir e ....

**Ant. III**

Këtù do të jes se më ka pëlkjier vendi.

**Apol.**

Të Lerit t'atë, o Mëma e Perëndis,gëzim përhapi në tërë jetën; se ngak Ti shkrepri Dielli i drejtësis, Krishti Perëndia jinë; e tue sglidhur nëmën dha bekimin, e tue prishur vdekjen, na dhuroi gjellën e pasosme.

**Kont.**

Me të Lerit t'atë, o e Papërlieme, u liruan Jakini e Ana nga turpi i shtërpëris e Adhami e Eva nga prishëria e morties. Populli jit e kremon se kle liruar nga ftesa e mëkatëvet. E shterpa lint Mëmën e Perëndis e Atë cë ushkjen gjellën t'ënë.

## Megalinarion

E pamëndëshme Virgjëria e mëmavet dhe e pandëlguashme Mëmëria e virgjëreshavet! Tek Ti, o Mëmë e Perëndis, të dia u ndodhënë. Andai na, gjithë jinit e jetës, pa u lodhurë Të lumërojëm!

## Kjinonikon

Kjelkjin e shëndeties u dua të marrë, dhe embërin e t'in'Zoti u dua të thërres. Alliluja.

## Opistavon

O Zoti Krisht, Perëndia jinë çë sheh gjithëkjish e gjithëkjish mëndë, Bëres i fukjishëm, Perëndi i famasësh, i Zot i burimevet të mirash, Liruesi i të dëshpëruamëvet e i të mjerëvet, Zëmëgjerë me atë çë të 'ftojën dishirimet, Ti çë Shërbëtorëvet t'atë Jakini e Anna, çë kishën rruar bashkë të pakjërtuashmë, helmin e shterpëris ja ndërrrove në harën e bijëris tue i dhënë më të bukurën pemë e gjirit, çë gojët e profet travet mistikjisht kishën paralajmuar se ki 'të lulëzoj nga rrenja e Jeseut, pemë nga e çila ki'të lehej Lulia çë ki't'mbloj jetën me të mirën erë, o fillim e mbarim i gjithë të miravet, Ti, nanë, çë je kroi i gjithë të miravet, burimi i dritës e dhënës i pasur, na dhe këta të ler për Dhuratën e Shpëtimin të të gjithëve.

Neve çë muarëm piesë te shërbesa shejte e Misterëvet të hijnushmë t'atë, na ruaj nga shterpëria e të bëmavet të mira e na bëj të mirë të bëjëm pemë virtutësh sa të hijëm te piesa e trazhgimit i të Drejtëvet te Rregjëria jote.

Bekò popullin t'ënt e ruaj trazhgimin t'ënt e mbroje nga çëdò sulm i armikjëvet e nga çëdò e ligë.

Shtò lëvdin e popullit i krështer e lartësoi fukjin e  
mbushe me të mira të kjiellit e të dheut, se Ti je kroi i  
gjithë të miravet, paj të parkalesivet e të shejtes Mëmë  
t'ënde e Zonjës t'ënë, e të Shejtravet me të cilët na të  
faliëm këtë lëvdì e të përmisurit t'anë Tij, bashkë me  
Atin e me Shpirtin, çë jep gjellë, nani e për gjithëmonë  
e për jetë të jetëvet. Amin.

Η ΥΨΟΣΙΟΣ ΤΩΝ ΤΙΜΙΩΝ ΙΑΝ



## **14 TË SHTATORIT**

### **Lartesimi i Krjkies**

**Ant. I**

O Perëndì, Perëndia jim, gjegjëmë, përcë më le?

Për parkalesitë të Mëmës t'ënde, o i Madh'in'Zot,  
shpëtona.

Lëvdì...nani...Për parkalesitë....

**Ant. II**

Përcë, o Perëndì, na ke mbajtur llargu Teje për  
gjithëmonë? Përcë dhizet mbëria jote mbi delet Të u-  
shkimit t'ënt?

Shpëtona, o i Biri i Perëdis, o Ti cë në kurm kleve vunë  
ngrikjë, neve çë të këndojojm Allilùia.

Lëvdì... nani...o i vetëmi Bir e ....

**Ant. III**

In 'Zot rregjiéròn, le të zëmbëronen popujit; Aì rri ujur  
mbi Hjeruvimtë, le të shkundet dheu!

**Apol.**

Shpëtò, o Zot, popullin t'ënt e bekò trazhgimin t'ënt;  
jipi Kjiveritarëvet mundie mbi armikjët, e paj Krikjes  
t'ënde ruaj Ti të krështerët t'atë.

**Isodikon**

Lartësoni t'en'Zonë Perëndin t'enë, e përmisij

nënkömbies e kömbëvet të Tij, se Ai isht shejt.  
Shpëtona, o i Biri i Perëdis...

### Kont.

O i Lartësuar në Krikjie tue dashur, rregjëris së ré çë ka embrin t'ënt lipisit t'ote dhuroi Ti, o Krisht Perëndi, dëfré me fukjin t' ende kjiverritarët t'anë tue dhënë atireve mundie kundra armikjëvet. Paçin atà ndihmën t'ende, si armë pakjie, trofë të pa-mundëshëm.

### Trisajon

Krikjen t'ende proskjinisiëm, o i madh'in'Zot, e Ngjallien t'ende të shejte lëvdojëm. (Tri herë)

O

Krikjen t'ende proskjinisiëm, o i madh'in'Zot, e Lartësimin shejt lëvdojëm. (Tri herë)

### Megalinarion

Ti, o Mëme e t'in'Zoti, je Parraisi mistikë, çë pa klënë shërbier, na dha Krishtin paj të çilit kle vunë në dhe Druri i Krikjies çë jep gjellë; andai nanì me lartësimin tue prokjinisur Atë, madhërojëm Tij.

### Kjinonikon

U dëftua mbi ne drita e fakjes s'ate, o i madh' in' Zot. Allilùia.

### Opistavon

O Madh'in'Zot, më i lart se çëdo lartësi, Ti deshe të duroje të ishe lartësuar me kurmin mbi Krikjën sa me të ndejturit e Krahëvet t'atë të rrnarie gjithënjëri tek Ti.

Ti, Perëndi, i lartësuar në' dhe përpara gjithë popujit si krahu i lart i të lartit At e i lëvduar me flijë lëvdimi, paj të lartësurit e të shtrejtes Krikje s'ate lirove naturën t' ënë çë u kishë përujurë njera në Pisë, e

lirove nga krenia e diejvet e i dhe mundien mbi mortien e shpale lirimin e 'saj nga nema e parë.

Mos përbuzë nanì, o i Madh'in'Zot, parkalesitë t'ona me të cilat të kemi lipur e po të lipiën lipisin t'ende.

Si i dhëmbëshëm kij lipisi për ne çë nderojëm të sbluarit e të përmisurit e Krikjes shejte. Kloft Ajò për ne ndihmë e fortë kuntra sulmëvet të drangonjëvet shpirtullorë çë na duanë shpirtin.

Me Krikjen ëna neve shëndetën si ja dhe të bijëvet e Israelit çë kishën klënë zënë nga ajet e gjalpërvet si të vërrëjënë gjalpërin brunzi çë Moiseu kishë ngrëjtur mbi shkopin.

Laj çëdo mëkatë çë do t'ngrëhet kuntra neve e ngre shtuara gjithë atà ndër nesh çë kemi rarë te mëkata.


E Kjiveritarëvet çë mburren mbi Krikjen t'ende uje posht çëdò kriengritje e të huajvet e drëmò çëdò krah të armikjëvet e çëdò lartësim të tiranëvet shuaje. E si kle mundur Ameliku me shengun e Krikjes te të ndejturit e krahevet të Moiseut, keshtu shprishë çëdò fukji çë ngrëhet kundra Klishës e çëdò të ngrëhet kundra të njohurit Tij.

Mbill çëdò gojë çë mahkon kundra teje. Ndritë çëdò zëmbër çë ka klënë erresuarë nga padituria. Llargar nga mendia jonë çëdò mendime çë na ndajën ngah Ti, sa na tue pasur mendien t'ënë të ngrëjturë nga mendime kjielli çë të lumërojn, të arrëjëm tek e përheshmia, e pasosmia dhe e vërteta ngrëhie çë i ngjet atireve çë kuloturë gjithëmonë ngah Ti, do të

trazhgojën edhë Rregjérin t'ënde.

Përcë Ti je Ai çë uj edhë ngrën e na të japiëm lëvdì Tij:  
Atit,Birit e Shpirtit Shejt,nani e përgjithëmonë e për  
jetë të jetëvet. Amin.

τὰ ἐισόδια Κυρίου



## **21 TË NËNDORIT**

### **Te hijturit e Shën Mëris në faltore**

#### **Ant. I**

I mathë isht in'Zot e i levduashëm shumë te kjiteti i Perëndis tënë, te mali i shejt t'Tij.

Për parkalesit...Levdì past...

#### **Ant. II**

Shejtëroi tendën e 'Tij i Larti.

Shpëtona, o i Biri...

#### **Ant. III**

Përpara fakjes s'ate ka t'ujën kriet të kjosmit e popullit.

#### **Apol.**

Sot na parathuhet pëlqjimi i t'in'Zoti e na paraleçitet shpëtimi i njerëzëvet. Te faltorëja e t'in'Zoti Virgjëresha na 'ftonet e gjithëve na paralajméròn Krishtin. Asaj me zë të mathë t'i thomi na: Gëzou Ti, i kujdesit i Stisorit mbarimi.

#### **Kont.**

Më e pastruara Faltore e Shelbuesit, shum ' e shtrejta Nusërore e Vigjëreshë, shejti thesàri i lëvdis s' Perëndis sot isht kallur në' shpi të t'in'Zoti tue bashkë këllitur Hirin e Shpirtit të Hjynushëm: Atë çë perimòjëm ëngjëjité e Perëndis. Këjò isht tenda e kjiellshme!

#### **Megalinarion**

Madhërò, o Shpirti jim, më të nderoshmen e më të lëvdoshmen ndër gjithë ushtrit e kjiellit.

Mistér tē math u shoh e tē humbët; pér kjiell shpellën; pér thronë ndér Hjeruvimt Virgjëreshën; grazhdin pér vend teku kle ngulur i Pasosmi Krisht Perëndia; tē Çilin tue kënduar madhërojëm na.

### Kjinonikon

Kjelkjin e shëndeties u dua tē marre embrin e t'in' Zoti u dua tē thërrés.

### Opistavon

Kush ka tē rrëfienjë, o i Madh'in' Zot, pushtetin t'ënt? Kush ka t'bënjë tē dsëhen lëvdit e mirësis s'ate pér ne?

Përçë, posa deshe tē sbëloje misterin çë mòti tē fshehurë e shpëtimit tē farës s'njerëzëvet pranë tē tē mishëruarit e Birit t'ënt, e posa deshe tē mbaroje tē taksurën bërë profitit David, sglodhe tē pastrën Mëmë t'ënde si ndenjë e tē dëftuarit t'atë në kurmë e kështù edhè si njeri njeriun shpëtove e me mishët marrë nga Ajò vepërove përgjeshien e njerëzis s'tërë.


Sot tue kremtuar tē Hijturit e kësaj Mëmie në Faltore, haristisiëm Tij, o i Madh'in 'Zot, Dhënesi i gjithë tē miravet e tē parkalesiëm paj t' saj tē shkëlkjenjë fakjia jote mbi ne e tē na dëftosh dhromin tue marrë tē çilin na mëndë t'i pëlkjejëm Mirësis s'ate, tē jemi shpëtuar nga sulmet e diejëvet e tē jetsiëm ndaj shpëtimit në pér pendesës e kështù me gëzim shpirti tē kremtojëm këtë ditë tē shejte.

Se Ti je Perëndi lipisie e ngushullimi e na tē japiëm lëvdì Tij: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e pér

gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop.: Amin

Shi' lehet Krishti, lëvdonie; shi ' vien nga kjiellia ju t'e pritëni. Shi' Krishti mbi dhet: ju ngrëhuni. Zotit po t'i këndonijeta e gjithë, edhë ndë gëzime, zëni kënka, popuj, ju se u lavdërua Ai.



ΕΠΑΓΓΕΛΙΟΝ

ΕΙ ΔΩΡΟΝ

## **20 TË DHIETORIT**

### Parakremptia e Krisht-Lindjes

#### **Apol.**

Përgatit u Vithlem, sibilit gjithëve Edhem. Stolisu Efrathà, se druri i gjellës te shpella lulëzoi nga Virgjëra. Pse Parrais gjiri i 'Saj u 'ftua shpirtulor tekupema e hjynushme nga e çila tue ngrënë rrojëm; ngë do të vdesiën si Adhami. Krisht lehet atë më pare e rare sa të ngjallënjë fitirë.

#### **Kont.**

Virgjëresha sot në shpellë vien për lindien e pathënëshme të t'paramotëshmes Fialë. Bën hare, ojeta e gjithë, ashtu si e gjegje; lavdërò bashkë me Ëngjëjit e me delmrët të paramotëshin Perendi, çë deshi t'ish par si Dialë i ri.



## **25 TË DHIETORIT**

### **Të lerit e t'in' Zoti Iisu Krishti**

#### **Ant. I**

Dua të lëvdonjë, o i Madihi' in'Zot, me gjithë zëmbrën t'ime; dua të rrëfienjë të gjitha famasmët t'ote.

Për parkalesitë... Levdì past...

#### **Ant. II**

I lum njeriu çë I trëmbet t'in'Zoti, e çë ja k'ënda shumë në urdhurimet e 'Tij.

Shpëtona, o i Biri i Perëndis, i ler nga Virgjérësha, neve çë të këndojojm alliluia.

Levdì past... nani...o i vetëmi Bir e ....

#### **Ant. III**

In'Zot I tha Zotit: uju tek e drejta jime njer çë të vë armikjët t'atë nën këmbëvet t'ote.

#### **Apol.**

Të lerit t'atë, o Kkrisht Perëndia jinë, jerdhi shkrepi në jetë dritën e dijturis; se për atë adhueruesitë e ijëzëvet nga ill klenë mësuar të adhurojën Tij si dielli i drejtësisë e të të njihien s' larti si lindie, o Zot, levdì Tij.

#### **Isodikon**

Nga gjiri jim më para se illi i mënätës U të leva.  
Béri bé in'Zot e ngë do të ket pendim: Ti je Prift për gjithëmonë i rradhës' Melkjisedhëkut.

### Kont.

Virgjëresha sot të përbiklënëshmin lind, e dheu shpellën të paarrënëshmit dhuròn. Engjëjtë me delmerët lavdërojën; Magjnjtë pra bashkë me illin udhëtojën; se për ne jerdhi e lindi si Dialë i ri i paramotshmi Perëndi.

### Trisajon

Oh sa në Krisht u pagzuat, me Krishtin u veshët.  
Alliluja. (Tri herë)

### Megalinarion

Madhërò,o Shpirti jim,më të nderoshmen e më të lë-vdoshmen ndër gjithë ushtrit e kjiellit.

Mistér të math u shoh e të humbët; për kjiell shpellën; për thron ndër Hjeruvimt Virgjëreshën; grazhdin përvend teku kle ngulur i Pasosmi Krisht Perëndia; të Çilin tue kënduar madhërojëm na.

### Kjinonikon

Shpëtim i dërgoi in'Zot Popullit t'Tij: Alliluja.

### Opistavon

O Krisht, Perëndia jinë, çë më para se gjithë jetët te lumëria e të pazënët At shkëlkjeve, e çë te të sprasmet kjëronje nga Virgjëra shejte u bëre njeri e leve ndër ne;

Ti çë për ne u bëre i vapëkë sa na të kjoseshëm me vapkësin t'ende;

Ti çë si fëmijë kleve pështruar me skutina e kleve ngulur me viershë i pandëlguashëm te një grazhdë;

Ti, o i Madh'in'Zot, çë mbanë gjithësin, prit mirë këtò

të përujme lëvdi e parkalesì t'ona, ashtu si prite mirë lëvdit të Delmerëvet e të përmisurit me dhureti të Magjinjëvet; e bënnatë mirë sa na bashkë' me Ushtrit e Engjénëvet të mariëm piesë te gëzimi i kjiellëshëm përgatitur për atà çë nderojën mirë të' LERIT t' atë të shejt; e jipi urtësi të Parëvet t'anë të besmë, përcë Ti do mirë njeriun e i lëvduar je me të pazënин At e me gjithëshejtin, i mirë e gjellëdhënës Shpirt, nanë e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Amin.

### **Apolisis**

Ai çë leu te një shpellë e kle shtruar te një grazhdë për shëndetën t'ënë, Krishti...



# **1 TË JANARIT**

## **Rrethpresia e Zotit Krisht**

### **Ant. I**

Ngrëni zërin të lëvdoni t'ën'Zonë, o gjithë dheu.

Për parkalesit... Levdì past...

### **Ant. II**

U gëzofshin kjielliat e bëft hare dheu.

Shpëtona, o I Biri i Perëdis, o Ti çë te nishët kleve rrighthëprer, neve çë t'këndojojmë alliluia.

Levdì past... nani...o i vetëmi Bir e ....

### **Ant. III**

Lipisit t'ote, o I madh 'in 'Zot, u dua të këndonjë pér gjithëmonë.

### **Apol.**

Fitirë njeriu pa u ndërruar more, Ti çë je Perëndì në klënie, o Zot, shumë I lipisiar,e tue mbaruar rrighthëprésien deshe të rieje në kurm, sa të shprishe errësirat e të ndsirie pështrimin e pesimevet t'anë. Lëvdì mirësis s'ate, lëvdì lipisis s'ate, 1ëvdì të parrëfieshmes, o Fialë zëmënjomësis s'ate.

### **Isodikon**

Ejani...Shpëtona o i Biri...Ti çë te mishët kleve rrighthprer...

## Apol.

Zëri jit dolli te gjithëjeta çë priti mire fialën t'ënde: pse si kish hjè t'in'Zoti ligjërove dogmët; bëre të ndëlganjë naturën e të klënievet, ndrekje zakonët e njerëzëvet. O Prift i Rrgjit Ati shejt, lutu Krishtit Perëndi të shpëtonjë shpirrat t'anë.

## Kont.

I Zoti i gjithësis duron rrëthëpresien e i mirë si ë pret mëkatët e njerëzëvet. Edhë bën harë te më i larti kjiell Aì çë isht i Stisorit Jerarhë e Dritar i hjinushëm i hijtur te Misteret e Krishtit, Vasiji.

## Megalinarion

Mbi Tij gëzonet, o e Hirplota, jeta e tërë. Mbledhia e ëngjëjet e jinia e njerëzëvet, o Faltore e shejtëruame, e Parrais i mëndshën, i Virgjéréshavet lëvdim, nga e çila in'Zot mori kurm e u bë Dialë, Aì çë isht i paramotshëmi Perëndia jine. Se brënda Teje vuri thrönin e 'Tij e gjirin t'ënt e bëri më të gjerë se kjielliat. Mbi Tij gëzonet, o e Hir-plota, jeta e tërë. Lëvdì Tij!

## Dittico

Kjiell folësin è Krishtit, dsënësin e Zotit, illin e ndritshëm, nga Kjesaria e Kapadhökëvet hora, Vasijin e Mathë të gjithë nderojëm na.

## Kjinonikon

Lëvdoni t'ënë Zone ju nga kjielliat, lëvdonie tek më i larti kjiell.

## Opistavon

O Krisht, Perëndia jinë, Ti çë përet mirë këtë flujim të

papërgjakëshëm e të mendçëm si flijim lëvdimi e latrë  
të këndëshme nga ata çë të thërresiën me gjithë  
zëmbërë, Ti je kjenkji e i biri i Perëndis çë nzier  
mëkatën e jetës, viçi i pafajshëm çë ngë do zigoin e  
mëkatës e për ne e nglakon me-hir, çë bënet piesë  
piesë e ngë ndahet, çë hahet e ngë sosë e shejtëron kë  
i merr piesë.

Ti për kujtim të pesimevet çë 'deshe të duroje e të të  
ngjallurit të triditëshem gjallësor t'ënt na bëre të  
mirriëm piesë te misteret t'atë të pathënëshem: 'n së  
kjielli e të dreruashëm të Shejtit Kurm t'ënt e të  
çëmuamit Gjak. Ruaj te të sejtëruarit t'atë neve  
shërbëtorët'atë, diakërit e të besmit kjiverritarë t'anë e  
ushtrin të krështere e popullin çë këtù ndodhet. Ëna  
neve në çëdo kjérò e mot të mejëtojëm drejtërin t'ënde  
sa, të udhëhekjur, të bënemi të mirë të rrimë tek e  
drejta jote kur të vishë të gjékoshë të gjallit e të  
vdekuritë.

Lirò vëllezëritë t'anë çë ran te duart e armikjë; prir  
siun t'ënt mbi ata çë jane të sëmurë, kjivarris ata çë  
ndodhen në rrëzikje; shpirrat e të ndëjemëvet çë  
vdikjën me shpresën e gjellës s'pasosme prej atie teku  
shkëlqjen drita e fakjes s'ate e gjekj gjithë ata çë të  
lipiën ndihëm.

Pse Ti je dhënësi i të miravet e Tij të japiëm lëvdi me të  
pazënин At t'ënt e gjithë-shejtin e i mirë Shpirt t'ënt  
nani e përherë e për jetë të jetëvet. Amin.

## **Apolisis**

Ai çë mbi të tetën ditë pranoi te kurmi Rrethpresien  
për shëndetën t 'ënë,Krishti....

Η ΒΑ'

ΠΙΣΙΔ.



## 6 TË JANARIT

Theofania e t'in Zoti Iisu Krishtit

### Ant. I

Kur Israeli dolli nga Egjipti, të bijët e Jakobit ngë gjegjën më gluhë të huaja.

Për parkalesitë... Lëvdì past...

### Ant. II

U dua mire t'ën'Zonë se Ai giejet zërin e luties t'ime.

Shpëtona o i Bir'i Perëndis, o Ti çë kleve pagzuar nga Jani në Jordhan, neve çë të këndojojm. Alleluia.

Lëvdì past... nani...o i vetëmi Bir e ....

### Ant. III

Lartësoni t'ën'Zonë se isht i mirë; se e pasosme isht lipisia e Tij.

### Apol.

Në Jordhan, kur pagzuar kleve, o i Madh'in'Zot u deftua lutia e Trinës, se zëri i Prindit të bë martirë Tij, tue Thritur Tij, Biri jim i dashuri, e Shpirti Shejt në fitirë pallumbi fortësoi vërtetësin e fialës. O Krisht çë u dëftove Perëndi e çë dritën i dhe jetës. Lëvdì Tij.

### Isodikon

I bekuar ai çë vien në embër të t'in'Zot. Perëndi isht in'Zot, e na u dëftua neve. Shpëtona...

### Kont.

U dëftove sot gjithë jetës e drita jote, o Zot, u shenua

mbi ne,çë me ndëlgjim të himnojëm: jerdhe u duke,o  
Dritë e pa-arrënëshme.

Oh! sa në Krisht u pagzuat, me Krishtin u veshët. Al-liluia.

### Megalinarion

Madhërò,o shpirti jim,më të nderoshme e më të lëvdoshmen ndër gjithë ushtrit e kjielliës.

Çëdo gluhe ngë mëndë të të lëvdonjë si të nget; edhë një mendëje Ëngjëjish sbiret kur do të t'këndonjë, o Mëma e t'in'Zoti.

Ti, posa je e mirë, pranò besën, psè Ti njeh edhë dashurin çë in'Zot na dha për Tij. Posa Ti je pështrimi i të Krështerëvet, na të madhërojëm.

### Kjinonikon

Na u dëftua Hiri i Perëndis për shëndetë të gjithë Njerëzëvet. Alliluia.

### Opistavon

E pathënëshme isht Dashuria jote për ne, o i Madh'in'Zot, Perëndia jinë.

Përçë Ti deshe se i vetëmi-ler Biri jit të mirrëjë kurmë nga një Grua e pamëkatë e të na glisëjë neve te gjithëkjishë, veç se te mëkata; edhë për ne të ishë pagëzuar si njeri nga Jani Prodhromi, pa pasur vëzonjë pastrim, pò sa, tue shejtëruar ujërat, të na dhurojë Rilindien nga ujet e nga Shpirti; sa na, tue njohur Tij, At i pazënë fill, i përmisemi Atij, lajmëruar nga kjiellia si pagëzonet, BIRI jit i dashuri; e të' lëvdojëm të gjithëshejtin Shpirt t'ënt, i sdripur mbi

Atë çë vien dëftuar Pagëzorit, tek i çili na klemë sfrajisurë e lierë për anë të pagëzimit e bërë piestarë të Krishtit t'ënt, nga i çili mos na llargò kurr, neve të mëkatruamë, po për anë të Tij fortësona kundra çëdò fukjì e kekje; e jipi fukjì të Parëvet t'anë të besmë kundra çëdò ngarie; e gjithë neve kjillëna te dhromi i Rregjëris t'ënde, sa edhë brënda neshë të jetë lëvduar Embri jit e të të Vetëmit-ler Birit t'ënt, bashkë me Shejtin Shpirt t'ënt, nanì e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Amin.

### Apolisis

Ai çë deshi të ishë pa gëzuar nga Shën' Janji te lumi i Jordanit për shëndetën t'ëne, Kr..



Η ΒΝΠΑΝΤΗ

ΜΡ ΒΥ

## **2 TË SHKURTIT**

Të përpjekurit T'in'Zoti Iisu Krishtit me Simeonin

**Ant. I**

Zëmbra jime buroi një fiale e mirë; u i këndonjë Rregjit të bëmat t'ime.

Per parkalesitë...Levdì... .Nani...

**Ant. II**

Lithë shpatën t'ënde rrethë ijës s'ate, o i fort, në bukuri e mirësi.

Shpëtona, o i Biri i Perëndis, i kjellur ngrahë nga i drejti Simeon, neve çë të këndojojm Alliluia.

Lëvdi... nani... .O i vëtëmi Bir...

**Ant. III**

Gjekjë, o Bijë, e vërrej e prir veshin t'ënt e harrò popullin t'ënt e shpin e t' it Eti e Rregji do të dishironjë bukurin t'ënde.

**Apol.**

Gëzou ,o e Hir-plota Mëmë e Perëndis Virgjëreshe: se ngah Ti leu,Dielli i drejtësis Krishti Perëndia jinë çë ndrit atà çë ndodhen në të errët.Bën harë edhe ti,o Plak i drejt,çë more ngrahë Liruesin e shpirtravet t'anë'çë jep neve edhë Ngjillien.

**Isodikon**

Dëftoi in'Zot Shpëtimin e'Tij përpara gjithë popujvet.  
Shpëtona...

## Kont.

O Ti çë një gji virgjëror shejtërove me të Lerit t'atë, e duart e Simeonit bekove si kishë hjè, nani jerdhe e shpëtove neve, o Krisht Perëndi. Bierna pakjen në plasëshit ndo luftë, jip fukji kjiverritarvet çë Ti do mirë, o i vetëmi njeridashës.

## Megalinarion

O Mëma e t'in'Zoti, shpresa e gjithë të krështerëvet, pështrò, ruaj gjithë atà çë shpresojën tek Ti. Na te hjeja e të shkruames s' Ligjës çë urdhuròn: "çëdò dialë çë del nga gjiri i së jëmës ka t' falet t'in'Zoti" shohiën një fitire. Andai të Paralindurin e të pazënitet AT, FIALËN, çë bënet i paralinduri i njëi Mëmie Virgjërë, madhërojëm na.

## Kjinonikon

Kjelkjin e shëndeties u dua të marr, e embrin e t'in'Zoti u dua të thérres. Alliluia.

## Opistavon

O i Madh'in'Zot, Perëndia jinë, çë dërgove tejeta të vetëmin-ler Bir t'ënt e Fialë, ler nga një grua, ler përposhë ligjës, sa të shpëtojë atà çë ishën përposhë ligjës, e, për anë të Shpirtit t'ënt, tue paralajmëruar të jardhurit e Tij Plakut Simeon, dhè ja dëftove kur Ai kle prur te Faltoria, Ti bekò edhë nani, me të shkëlqjierit t'atë, neve shëbërtorë t'atë të mëkatruamë, e pritë mirë parkalesitë t'ona, si prite mirë skomollin e Profeteshës Anë. Bënnë të narriëm mbë duarë në shpirt Fialën t'ënde bërë njeri, e të jemi bërë na faltore të shejtëruame të Shpirtit t'ënt gjithë i shejt.

Gëzò me fukjin t'ënde të Parët t'anë të besmë, e jipi mundie mbi të ligën, sa edhè brënda neshë të jet lëvduar i madhëruashmi embër jit Ai të të vetëmit-ler Bir t'ënt, e të Shpirtit t'ënt i përmisur e çë jep gjellë, nanì e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

### Apolisis

Ai çë deshi të ishë marrë mbi duar nga i drejti Simeon për shëndetën t'enë, Krishti....



## **25 TË MARSIT**

Lajmërimi Zonjës Po-Virgjërë Mëmës e t'in'Zoti

### **Ant. I**

O Perëndi, jip gjikimin t'ënt Rregjit e drejtësin t'ënde të Birit të Rregjit.

Per parkalesitë...Levdì...nani...

### **Ant. II**

Ka të sdripet si shi mbi të korrët, e si pikë çë kullon mbi dheun.

Shpëtona, o i Bir'i Perëndis, o Ti çë nga një Virgjërë more kurm, neve çë të këndojojm. Alliluja.

Levdì... nani... O i vetëmi Bir...

### **Ant. III**

Kat jet bekuar embri i Tij për gjithëmonë.

### **Apol.**

Sot zë fill Shpëtimi jine e dëftonet misteri i përjetëshëm. I Biri i Perëndis bënët Bir i Virgjëreshës e Gabriili Hirin lajmëron. Andai bashkë me atë Mëmës s'Perëndis thomëji: Falem, o e Hir-plota, in'Zot ë me Tij.

### **Isodikon**

Lajmëroni ditë për ditë shpëtimin e Perëndis t'ëne.  
Shpëtona...

### **Kont.**

Tij, o Kaptenjë luftare kënka të mundies, se më lirove

prej këkjish tē fala nderies, u ngreh po Tij kjiteti i jit, ēm'e tē lartit. Pran tue pasur Ti pushtetin e pamündëshim, po shpëtomë Ti pérherë prej rrëzikjëvet. Tē thérres tek Ti: Tē falem Nuse povirgjëre.

### Megalinarion

O dhe, lajmérò gjëzim tē Këndoni, kjiej, lëvdin e Perëndis. Si Ark e gjallë e Perëndis, dorë e huaj Kurr t'e ngasnje; buzë tē tē besmëvet tue kënduar pa pushim Mëmës s' Perëndis zérin e Ëngjëllit, tē thérresien me harë: falem, o e hir-plota, in'Zot me Tij.


### Kjinonikon

Sglodhi in'Zot Sionin e e dishiroi pér shpi t'Tij. Alliluia.

### Opistavon

O i Madhi'in'Zot, Perëndi i gjithë-mëndëm, çë tē pëlkleu se Biri jit i vetëmi-ler tē mirrëjë mishë nga një Virgjërë e tē bënejë njeri pér shëndetën t'enë, e çë dërgove Arkëngjëllin t'ënt Gavriilin sa't'i lajmërojë Shejtes Virgjërë Mëri tē Zënit e'Saj pa njohur burrë, tē çilin më para se gjithë jetët kishe bërë tē' ishë shërbëtori tē këtij Misteri tē dreruashëm dhà njohur Tij'e Atij, Fiala jote gjithënjë e klënëshme, Ti vet, pér parkalesitë e Saja e tē gjithë Shejtravet t' atë, lajmérò shpirtravet t'anë, paj tē Hirit t'ënt, ndëjesën e mëkatëvet e gjëzimin i pasosmë. Dhurò pakje mbi popullin t'ënt, e dëftò neve'dhromin, tue jetsur tek i cili, bënemi tē mirë pér Rregjérin t'ënde tē kjiellëshme.

Paj tē lipisis tē Krishtit t'ënt me tē çilin je bekuar, bashkë me gjithë shejtin, i mirë e çë' jep gjellë Shpirt t'ënt, nani e pér gjithëmonë e pér jetë tē jetëvet. Amin.



## **6 TË GUSHTIT**

### **Shperfytirimi i t'in' Zoti Iisù Krishtit**

#### **Ant. I**

I mathë isht in'Zot e i lëvduashëm shumë te kjiteti i Perëndis, te mali i shejt i'Tij.

Për parkalesitë...Levdì...nani...

#### **Ant. II**

Themelet e' Tij te malet të shejt.

Shpëtona, o i Biri i Perëndis, o Ti çë te mali i Thaborit u shpërfitërove, neve çë të këndojojmë Allilùia.

Levdì... nani... O i vetëmi Bir...

#### **Ant. III**

Lipisit t'ote, o i Madh'in Zot, ka të këndonjë për gjithëmonë.

#### **Apol.**

U shpërfitërove te mali, o Krisht Perendì, tue dëftuar Dsënsëvet t'atë lëvdin t'ënde ashtu si mëndë. Shkrepë edhë mbi ne të mëkatruamit dritën t'ënde të përjetëshme, për lutjet e Mëmës s'Perëndis. O Dritëdhënës, Lëvdì Tij!

#### **Isodikon**

Thavori dhe Ermoni do të gëzonen mbi embrin t'ënt...

#### **Kont.**

Mbi malin u shpërfitërove, e, për sa mëndë, Dsënsit t'atë, o Krisht Perendì, patën lëvdin t'ënde; sa, kur të

shohiën vunë n'krikjë, tē ndēlgojēn se pesimi jit isht i vullneshëm, e t'i ligjerojēn jetesë se Ti je me tē vērtetë paskjērimi i Atit.

### Megalinarion

Nanì ndihen shërbise tē pagjejura! Zëri i Atit me lëvdì e madhe i bën deshmi tē Birit çë leu pa At nga Virgjëresha tue thënë se Aì vet isht Perëndì edhè Njeri per gjithëmonë.

### Kjinonikon

Te drita e lëvdìs s'fakjes s'ate, o i Madh'in Zot, na do tē jetsiën pér gjithëmonë. Allilùia.

### Opistavon

O i Madh'in'Zot Iisus Krisht Perëndia jinë, khillëna tek i shejti malë tē dashuris, si kjelle krietaryt e Apostojvet t'atë tek i larti malë; e sbillëna sit e mendies sa mëndë tē vërrejëm tē parrëfieshmen bukurì, si atire i dëftove tē shkëlkjierit e fitirës tē kurmit t'ënt me një tē llambarisur tē jashta-zakonëshëm, tue njobur atà dritën t'ënde tē perëndishme paj tē kurmit t'ënt.

Kjill edhè neve tek e mira me tē drejtën t'ënde e gjithëmëndëme.

Ti çë Fitirën t'ënde tē shejte e sbukurove mbi çëdò fialë, bëjë tē ndiejëm na zotërin t'ënde çë Moiseu si edhè Elia deshmuani; e bënnë tē kujtojëm kurdoherë zërin e tē pa-zënit At, çë tē thërriti "Bir i dashur"; sa na tue ruajtur urdhurimet t'atë tē shkëlkjejëm bashkë me atà çë klenë bërë tē mirë pér Rregjérin t'ënde tē pasosme, tue par tek Ti tē pa-zërin At t'ënt, me tē

çilin, je bekuar bashkë me të gjithëshejtin, i mirë e gjellëdhënës Shpirt t'ënt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

### Apolisis

Ai çë ndërroi Fitirën e Tij në lëvdi mbi malin e Thavorit përpara Dsënësëvet e Apostojvet të shejt t'Tij Krishti, Perëndia jine,..

И КОИНИС ТИС ФЕТОК



## **15 TË GUSHTIT**

### **Të flëjturit e të hipurit në kjell e Shën Mëris**

#### **Ant. I**

Ngrëni zërin të lëvdoni t'ën 'Zonë, o gjithë dheu;  
këndoni embrin e 'Tij, nderoni lëvdin e 'Tij.

Për parkalesitë...Levdì...nani...

#### **Ant. II**

In ' Zot do diert e Sionit më shumë se gjithë tendat e  
Jakòbit.

Shpëtona, o i Biri i Perëndis, i famasëshmë ndër  
shejtrat, neve çë të këndojojm Allilùia.

Levdì... nani... O i vetëmi Bir...

#### **Ant. III**

Gati ë zëmbra jime, o Perëndi, gati ë zëmbra jime; dua  
të këndonjë e të msal te lëvdia jime.

#### **Apol.**

Te të lerit Ti e ruajtie virgjérin; te të flëjturit ngë e le  
jetën, o Mëma e Perëndis; shkove te gjella Ti çë je  
Mëma e gjellës, me lutiet t'ote tue shpërblier nga  
vdekjia shpirtrat t'anë.

#### **Kont.**

Mëmën e Perëndis të paflëjturë në lutie, e në mburonjë  
shpresë të patundurë, varri e vdekjia ngë e mundën;  
se si Mëmë të gjellës, e bëri të shkoj te gjella Aì çë jesi  
ne gji të virgjërë, për gjithëmonë.

## Megalinarion

Gjithë jinit lumerojën Tij, e vetmia Mëmë e Perëndis. Tek Ti, o Virgjërë e dëlirë, janë mundur ligjet e naturës; Ti linde e Virgjërë kjëndrove e vdekja paralajméròn gjellën. O Mëmë e Perëndis, çë kjëndrove Virgjërë pas lindies e gjallë pas vdekjes, shpëtò gjithëmonë trazhgimin t'ëntë.

## Kjinonikon

Kjelkjin e shëndetëjes u dua të marr, e embrin e t'in Zoti u dua të thërrës. Allilùia.

## Opistavon

O Krisht Perëndia jinë, çë me mortien Mëmën t'ënde e pa mëkatë nga gjella e shkove te gjella e pasosme, e çë atë e sdripurë në varrë të prishëris e bëre më e lartë mbi çëdo fialë, e çë për varrzimin e 'Saj mbjodhe nga gjithë anët e jetës Apostojitë t'atë, Ti vetë nani, për parkalesitë e 'Saj, gjithë neve çë nderojëm mortien e Saj lirona nga çëdò vdekjie mendie e punie, e shpëtona nga çëdo mortie Shpirti, e ruana nga mortia e dishpërimit, si edhë ruana nga varri i pabesëris e nga besa e shtrëmbërë; ruaj edhë të Parët t'anë nga çëdò e ligë; e të gjithë bën-na të mirë për gjellën e pasosme, përcë Ti do sa gjithënjeri të shpëtonen, e Tij të nget çëdò lëvdì, bashkë me Atin të pa zënë fill, e me gjithë shejtin, i mirë e gjellëdhënës Shpirt t'ënt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.



# **TRIODION E DIELLIA E PARË TË KRESHMËVET ORTHODOXIA**

**Ant. I**

In'Zot rregjeron e pështronet me nder të mathë; In'Zot vishet e me fukji rrethonet.

Për parkalesitë...Levdi....nanì....

**Ant. II**

Le të lëvdojën t'ën'Zonë per lipisìn e'Tij e për famasmë çë ka bër për bijët e njerëzëvet.

Shpëtona...Lëvdi ...nanì...O i vetmi....

**Ant. III**

E lëvdofshin kjielliat e dheu e dejti e çëdo tundet ndë'të.

**Apol.**

Fitirës t'ënde e dëlirë i përmisemi o i Mirthë, tue lipur ndëjesën e mëkatëvet t'ona o Krisht Perëndi. Pse Tij të pëlqjeu të ishe me kurmin vierrë në Krikjë, sa të liroje neve nga duart e armikut. E tue haristisur Tij thëresiën: mblove të gjithë me harë. o Shpëtuesi i jinë, posa jerdhe të liroje jetën.

**Kont.**

Tij, o kaptenjë, luftare kënka të mundies, se më lirove prej këkjish të falanderies, u ngreh po Tij kjiteti i jit, èm' e të Lartit. Pran tue pasur Ti pushtetin e pamundëshim, po shpëtomë Ti pérherë prej

rrëzikjëvet. Të thërres tek Ti: të falem Nuse Povirgjërë.

### Megalinarion

Mbi Tij gëzonet, o e Hir-plota, jeta e tërë! Mbledhia e Ëngjëvet e jinia e njerëzëvet, o Faltore e shejtëruame, e Parrais i mendshëm, i Vigjëreshavet lëvdim, nga e çila in Zot mori kurm e u bë Dialë, Ai çë isht i paramotshmi Perëndia jinë. Se brënda Teje vuri thronin e'Tij. E gjirin t'ënt e bëri më të gjerë se kjielliat. Mbi Tij gëzonet, o e Hir-plota, jeta e tërë! Lëvdì Tij!

### Kjinonikon


Lëvdoni t ën'Zonë ju nga kjielliat, lëvdoni Atë tek më i larti kjiell. Alliluia.

### Opistavon

O i Madh'in'Zot, Perëndia jinë, na i piremi mirësis s'ate e thomi: gjekjë parkalesitë e shëbëtorëvet t'atë të mëkatruamë e ëna të arrëjëm të mbarojëm këtò ditë të lume të argjërimit, çë Ti na dhuron sa të shejtëronemi me të mirat e dheut e pranë të kemi edhë të mirat të ardhëshme çë akjë dishirojëm.

Dçishëna nga vepra të errësirës e kjosna me atò të driftës; dhurona hirin e pendimit të ftetë dhe e parkalesis e përujëshme, ajò çë pëlqjen Tij.

E të Parët t'anë të besmë, edhë atà me argjërime e me parkalesi shkëlkjefshin për mundësi e këtë për lipisin të të vetëmit-ler Bir t'ënt me të çilin je i bekuar bashkë me Shpirtin Shejt çë jep gjellë, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amìn!



ΜΗΤΡΟΣ Ε

ΕΙΣ ΤΗΝ ΕΛΑΥΑΝΗ

# **E DIELLIA E TRE TË KRESHMËVET STAVROPROSKINIS**

## **Ant. I**

U dëftua mbi ne drita e fakjies s'ate, o i Madh'in'Zot; i dhe gëzim zëmbrës t'ime.

Per Parkalesitë... Levdì... nani....

## **Ant. II**

Gjithë anët e Botës pane Shëndetën e Perëndis t'ënë.

Shpëtona... Levdì...nani...O i vetmi Bir....

## **Ant. III**

Lartësoni t'ën'Zonë Perëndin t'ënë e përmisij nënkëbies e këmbëvet të Tij, se Ai isht Shejt.

## **Apol.**

Shpëto, o Zot, popullin t'ënt e bekò trzhgimin t'ënt; jipi kjiveritarëvet mundie mbi armikjët, e paj të Krikjes t'ënde ruaj Ti të krështerët t'atë.

## **Isodikon**

Lartësoni t'ën'Zonë Perëndin t'ënë e përmisij nënkëbies e këmbëvet të Tij, se Ai isht Shejt. Alliluia.

## **Kont.**

Tij, o kaptenjë, liftare kënka të mundies, se më lirove prej këkjish të falanderies, u ngreh po Tij kjiteti i jit, ëm' e të Lartit. Pran tue pasur Ti pushtetin e pamundëshim, po shpëtomë Ti përherë prej rrëzikjëvet. Të thérres tek Ti: të falem Nuse Povir gjëre.

### **Trisajon**

Krikjen fènde proskjinisiëm, o i Madh'in'Zot, e  
Ngjallien t'ënde té shejte lëvdjëm.


### **Megalinarion**

Mbi Tij gëzonet, o e Hirplota, jeta e térë! Mbledhia e  
ëngjéjvet e jinìa e njerëzëvet, o Faltore e shejtëruame, e  
Parrais i mëndshën, i Virgjéréshavet lëvdim, nga e çila  
in' Zot mori kurm e u bë Dialë, Aì çë isht i  
paramòtshëmi Perëndia jine. Se brënda Teje vuri  
thrònин e 'Tij e gjirin t'ënt e bëri më té gjerë se kjelliat.  
Mbi Tij gëzonet, o e Hir-plota, jeta e térë. Lëvdi Tij!

### **Kjinonikon**

U dëftua mbi ne drita e fakjies s'ate, o i Madh'in'Zot; i  
dhe gëzim zëmbrës t'ime. Alliluia (3)

Η βαΐφορά



# **TEK E DIELLIA E PALLMIEVET**

**Ant. I**

U dua mire t'ën'Zonë, se Ai gjegjet zérin e luties t'ime.

Per parkalesitë...Levdì....nani..

**Ant. II**

Pata besë, përandai fola; u kleva shumë i mieruamë.

Shpëtona, o i Biri i Perëndis, o Ti çë u uje mbi një polistrë gjadurie, neve çë të këndoja. Alliluia.

Levdì...nani...O i vetmi Bir....

**Ant. III**

Lartësoni t'ën'Zonë se isht i mire; se e pasome isht lipisia e Tij.

**Apol.**

Ngjallien e të gjithave tue vërtetuar më para se pesimi jít, ngjalle Lazarin së vdekurish, o Krisht Perendi. Andai edhe na si ata djelm, tue kjellur shengjet e mundësis, Tij çë munde vdekjen thërresëm: Osanna te më të lartit. I bekuar Ai çë vien në embër të t'in'Zoti.

**Isodikon**

I bekuar Ai çë vien në embër të t'in'Zoti. Perendi isht in'Zot, e na u dëftua neve. Shpëtona...

**Apol.**

Ngjallien e të gjithave tue vërtetuar....

Të varrëzuar me Tij pr'anë të pagëzimit, o Krisht Perëndia jinë, klemë bër të mire për gjellën të pavdekëshme në Ngjallien t'ënde e na me himne këndojojm: Osanna te më të lartit. I bekuar Ai çë vien në embër të t'in'Zoti.

### Kont.

Në kjiell mbi Thronin, në dhë mbi gjadurin ujur, o Krisht Perendì, prit mire lëvdit e Ëngjëjvet e himnet e fëmijës çë të ulurijën: Bekuar je Ti, çë vien të ngrësh Adhamin i rar.

### Megalinarion

Perendì isht in'Zot edhë na u dëftua neve. Kremtioni e me gëzim, ejani madhërojëm Krishtin, me pallmie e me degë tue kënduar himnin, i bekuar Ai çë vien në embër të t'in'Zoti, Shpëtuesi jinë.

### Kjinonikon

I bekuar Ai çë vien në embër të t'in'Zoti. Alliluia.

### Opistavon

O Krisht Perëndia jinë, na lëvdojëm të jardhurit t'atë ndër nesh të pa-rrëfieshëm! Se tue pasur kjiellin si thronë e dheun si nën këmbie, ngë përbuze të mirrie mishë nga Shejtia Virgjërë e të leheshe si njeri e të ishe vunë te një grazhdë kafshashë si fëmijë, po edhë të ujeshe mbi një gjajdhurë e me hirë të duroje pesime për ne; Ti çë je lëvduar si Perëndì me këndime pa të sosurë nga Fukjit e kjiellit, e mëson lusmën e paftesme të këndonjë mbi dhe një këndim i ri: " Përcë nga goja e fëmijës e të atirëve çë pin sis merrë lëvdin " e gluhet (belbësonjëse) çë ngë flasiën mirë i mëson të këndojojn lëvdin në kjiell e pakjen mbi dhe.

Me atà edhè neve shërbëtorë t'atë të mëkatruamë prit mirë, neve çë të këndojojmë kënkën e mundësis, Ti çë munde mortien, tue thënë: " I bekuar je Ti çë vien në embër të t'in'Zoti ", pa lënë lëvdin e t'it Eti e çë pameta ka të vishë të bëshë ligjë mbi jetën me drejtësi.


E bënnna të mirë të ngjipemi me Tij e të jemi pritur mirë te lëvdia jote tue na sbukuruarë me luftimet mundësorë mbi dishirimet e likjë e tue na kurorëzuar me bukurin e virtutëvet në vent të pallëmievët e të degëvet, sa na me gjëzim të' vijëm të përpiekëjëm Tij, çë vien në lëvdi në për miekullavet e të bënemi trazhgimëtarë të Rregjëris t'ënde.

Jipi mundie mbi të ligën të Parëvet t'anë të besmë, përcë Ti je i lipisiar e i lëvduashëm, bashkë me Atin t'ënt të pa zënë fill e me gjithë Shejtin, i mirë e çë jep gjellë Shpirt t'ënt, nanë e për gjithëmonë e për jëtë të' jetëvet.

Amin!

### Apolisë

Ai çë deshi të ujejë mbi një polistrë gajdhurie për shëndetën t'ëne, Krishti,..



## **TE DITA E MADHE E SHEJTE E PASHKËVET**

Krishti u ngall. Ai tue vdekur ndridhi vdekjen e shkret e të vdekurëvet te varret i dha Gjellën e vërtet.

(Tri herë)

U ngrëfshit Perëndia e klofshin shprishur armikjët e t' Tij e jikëshin përpara fakjes s'tij atà ç'i mbajën mbri.

Ashtu si shduket kamnoi, u shdukëshin; si joset dilla përpara ziarrant.

Ashtu kanë të humbiën të mëkatruamit përpara Perëndis; e të drejtit le të gëzonen.

Kjo isht dita çë bëri in'Zot: le të gëzonemi e të bëjëm harë te kjò ditë.

**Ant. I**

Ngrëni zërin të lëvdoni t'en'Zonë, o gjithë dheu.

Për parkalesitë të Mëmës t'ende, o i Madh'in'Zot, shpëtona.

Lëvdi past...nani....

**Ant. II**

Perëndia paçit lipisi për ne e na bekofshit; le t'dëftontë fakjen e' Tij neve e na paçit lipisi.

Shpëtona, o i Biri i Perëndis, i njalluri s'vdekurish, neve çë të këndojojmë Alliluia.

Levdì...nani...O i vetmi Bir....

### **Ant. III**

U ngrëfshit Perëndìa...

### **Apol.**

Krishti u ngall. Ai tue vdekur ndridhi vdekjen e shkret e të vdekurëvet te varret i dha Gjellën e vërtet.

### **Isodikon**

Te mbledhiet bekoni t'ën'Zonë, Perëndin nga burimet e Israelit.

Shpëtona, o i Biri i Perëndis,....

### **Apol.**

Krishti u ngall....

Si grat me Marien, më parë se të'bëj ndriçullë, gjetën gurin e varrit të rogollisur, gjegjën nga Ëngjëlli : Përçë kërkoni ndër të vdekurit si njeri Atë çë jes në dritë të pasosme? Vërreni pëlhirët e varrit. Rridhni e lajmëroni jetës si u ngre i n'Zot tue dhënë vdekje vdekjes, pse Aì ë i biri i Perëndis çë Shpëtoi njerëzin.

### **Kont.**

Ti në varr u sdripe, o i Padekshim, po e monde pushtetin e Pisës e u ngalle si Mundësor, o Krisht Perëndì, Gravet Mirrëprurëse tue thënë: Gëzonij, e Apostojvet t'atë tue dhëruar pakjien, o Ti ç jep të rarëvet Ngjallien.

### **Megalinarion**

Engjëlli i thërrisëj Hir-plotës e Shën Mëri: Moj Virgjëre e dëlirë, po' gëzou,u Të thom,gëzou.

Se jit Bir u ngre tri ditësh nga Varri edhë ngrëjti të

vdekurit. E ju, popuj, harè tē bëni! Ndritu, ndritu! Ti Jerusalim e re, po ndritu, pse lëvdia e t'in'Zoti mbi Tij u dëftua. Bëj harè e nani gëzou, Sion! E TI e dëlirë, Mëma e Perëndis, bëj haidhì te tē ngjallurit e Diallit t'ënt.

### Kjinonikon

Kurmin e Krishtit mirrëni, kroin tē pavdekshëm njepsni, Alliluia.

### Opistavon

Sot, o Vellezërë, na dëftonet një ditë e shkëlkjieme edhe gjellëdhënësë: Ngjallia e t'in'Zoti Iisu'Krishti! Andai sot Klisha e t'in'Zoti mbalonet me tē besmë. Shumë vetë nga atà jo vetëm kjellën barrën e argjërimit, po sot, tue dhezur me kujdes llëmpët, kanë prurë dhurata Rregjit i jetëvet.

Për tē ngjallurit e Krishtit, Perëndis t'ëne, gëzonet tërë gjithësia: kjielli fiellonet me tē shkëlkjierit e Perëndis; bota stoliset, dejti kjetësonet; tirannët pushojën; tē besmit shumësonen, katekumenjtë marriën dritën, armikjët bëjën pakjë, tē sbierrit priren, mëkatë janë ndëjerë, klishët gëzonen e Krishti Perëndi isht lëvduar. Mëmat te krahët e'tire tē ndritshmë bien dhureti Rregjit i jetëvet, jo lule zahari, po Hirin e Shpirtit e tē ndriturëvet tē ri.

Andai flijën e tē përmisurit t'ënë, tē neve priftra tē mierë, prit mirë, o i Madh'in'Zot.

Ena ndëjesën e mëkatëvet çë këmi burë çë nga dielmëria jonë njera në plekjëri, si i mirë e dashamirë çë je, o Perëndia jinë.


Kjivertarëvet t'anë jipi mundie mbi armikjët.

Despotin t'ënë ruaje te Throni i shtrejtë i tij.

Gjithë priftërin dhe popullin mbaji në pakje e një mendie.

Popullin çë ndodhet këtù, çë isht e trazhgon të marrit piesë te të gjellëdhënës, të dëlirë, të hjynushmë Misterë:

Ruajie, mbroje, kiji lipisi paj të Po-Vjgjërës Shë 'Mëri, paj të Apostojëvet, përcë Ti je i Ngjialluri së vdekurish e na të japiëm lëvdi Tij : bashkë me të pazënин At e me gjithëshejtin e gjellëdhënësin Shpirt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.



## **TEK E DIELLIA E THOMASIT**

### **Ant. I**

Ngrëni zérin tē lëvdoni t'ën'Zonë, o gjithë dheu.

Për parkalesitë tē Mèmès t'ende, o i Madh'in'Zot,  
shpëtona.

Lëvdi past...nani....

### **Ant. II**

Perëndia paçit lipisi per ne e na bekofshit; le t'dëftonjë  
fakjen e'Tij neve e na paçit lipisi.

Shpëtona, o i Biri I Perëndis, i ngjalluri s'vdekurish,  
neve çë tē këndojojm All.

Lëvdì...nani...O i vetmi Bir....

### **Ant. III**

U ngrëfshit Perëndia e klofshin shprishur armikjët e  
t'Tij e jikëshin përpara fakjes s'tij atà ç'i mbajën mbri.

### **Apol.**

Krishti u ngall. Ai tue vdekur ndridhi vdekjen e shkret  
e tē vdekurëvet te varret i dha Gjellën e vërtet.

### **Isodikon**

Te mbledhiet bekonи t'ën'Zonë, Perëndin nga burimet e  
Israelit.

Shpëtona, o I Biri I Perëndis,....

## Apol.

Krishti u ngall. Ai tue vdekur ndridhi vdekjen e shkret e tē vdekurëvet te varret i dha Gjellën e vërtet.

Megjithëse varri ishë vulosur, Ti gjella dolle jashta, o Krisht Perëndi; e me diert tē mbëllime u parakjite përpara Apostojvet, o Ngjallia e gjithëve! Paj t'tire, përtërijna Shpirtin Shejt, përsa e madhe isht lipisia jote.

## Kont.

Ti nē varr u sdripe, o i Pavdekshim, po e monde pushtetin e Pisès e u ngalle si Mundësor, o Krisht Perëndi, Gravet Mirë-prurëse tue thënë: Gëzonij, e Apostojvet t'atë tue dhëruar pakjien, o Ti çë jep tē rarëvet Ngjallien.

Kur Ti, o Krisht Perëndi, me diert tē mbëllime hire nē mes t'Apostojvet, Thomai me tē drejtën e dishiruame tē ngisëj shkjirtoi brinjën t'ende, krua gjellie e tē thirri: Ti jé i Zoti i jim, Perëndia i jim!

## Megalinarion

Engjëlli i thërrisëj Hir-plotës e Shën Mëri: Moj Virgjërë e dëlirë, po' gëzou, u Të thom, gëzou.

Se jit Bir u ngrë tri ditësh nga Varri edhë ngrëjti tē vdekurit. E ju, popuj, harë tē bëni! Ndritu, ndritu! Ti Jerusalim e re, po ndritu, pse lëvdia e t'in'Zoti mbi Tij u dëftua. Bëj harë e nanì gëzou, Sion! E TI e dëlirë, Mëma e Perëndis, bëj haidhì te tē ngjallurit e Diallit t'ënt.

## Kjinonikon

Lëvdò, o Jerusalim, t'ën Zonë; këndo Perëndis t'ënt, o Sion. Alliluia.

## Apolisis

Ai çë shkeli mortien e Thomasin urtësoi, Krishti...



## **E DIELLIA E MIROFORËVET**

### **Ant. I**

Ngrëni zërin të lëvdoni t'ën'Zonë, o gjithë dheu.

Për parkalesitë të Mëmës t'ënde, o i Madh'in'Zot,  
shpëtona.

Lëvdi past...nani....

### **Ant. II**

Perëndia paçit lipisi për ne e na bekofshit; le t'dëftontjë  
fakjen e'Tij neve e na paçit lipisi.

Shpëtona, o i Biri i Perëndis, i ngjalluri s'vdekurish,  
neve çë të këndojojm Allilua.

Levdì...nani...O i vetmi Bir....

### **Ant. III**

U ngrëfshit Perëndia...

### **Apol.**

Krishti u ngall. Ai tue vdekur ndridhi vdekjen e shkret  
e të vdekurëvet te varret i dha Gjellën e vërtet.

### **Isodikon**

Te mbledhiet bekonit t'ën'Zonë, Perëndin nga burimet e  
Israelit.

Shpëtona, o i Biri i Perëndis,....

### **Apol.**

Kur u sdripe nga vdekjia, o Gjellë e pavdekshme,

atëherë Pisës vdekjen i dhe me të shkëlkjierit e Hjnis, Atëherë nga nënshtresat e dheut të vdekurit ngjalle. Gjithë fukjit të larta ëngjëllore po thërresiën: o Gjellëdhënës Krisht, Perëndia jinë, lëvdi Tij.

Bujari Josif Kurmin t'ënt të pangar e sdripi nga Krikja e në pëlhirë të pastrë e pështolli e me aromë te një varr i ri me lip të math e vuri, pò tri ditësh u ngreve, o Zot, tue dhënë jetës të madhen lipisi.

Gravet miroforë një ëngjëll çë rrij përpara varrit i tha: aromët janë të mirë për të vdekuritë; Krishti u dëftua i pangarshëm nga prishëria. Po ulurini: U ngjall in'Zot tue dhënë jetës të madhen lipisi.

#### Kont.

Ti në varr u sdripe, o i Padekshim, po e monde pushtetin e Pisës e u ngalle si Mundësor, o Krisht Perëndi, Gravet Mirreprurëse tue thënë: Gëzonij, e Apostojvet t'atë tue dhëruar pakjien, o Ti ç jep të rarëvet Ngjallien.

Tue thënë “Gëzonij” Miroforëvet bëre të sosëj vajtimi i të parës mëmë Evës me të ngallurit t'at, o Krisht Perëndi. E Apostojvet t'atë urdhurove të ligjerojnë: “U ngre nga varri Shpëtuesi!”.

---

Oh! Sa në Krisht u pagëzuatë, me Krishtin ju veshët.  
Alliluia.

## Megalinarion

Engjëlli i thërrisëj Hir-plotës e Shën Mëri: Moj Virgjërë e dëlirë, po' gëzou,u Të thom,gëzou.

Se jit Bir u ngre tri ditësh nga Varri edhë ngrëjti të vdekurit. E ju, popuj, harë të bëni! Ndritu,ndritu! Ti Jerusalim e re, po ndritu, pse lëvdia e t'in'Zoti mbi Tij u dëftua. Bëj harë e nani gëzou, Sion! E TI e dëlirë, Mëma e Perëndis, bëj haidhì te të ngjallurit e Diallit t'ënt.

## Kjinonikon

Kurmin e Krishtit mirrëni, kroin të pavdekshëm ngjepsni, Allilua.



# **TE DITA E TË HIPURIT NË KJIELL TË T'IN'ZOTI**

## **Ant. I**

O ju të gjithë popujitë, kësini duart; ngrëni zërin  
Perëndis me zërë hareje.

Për parkalesitë.... Lëvdì...nani...

## **Ant. II**

I mathë isht in'Zot e i lëvduashëm shumë te kjiteti i  
Perëndis, te mali i shejt i'Tij.

Shpëtona, o i Biri i Perëndis, çë ngak na u ngjipe në  
kjiell me lëvdì, neve çë të këndojojm Allilùia.

Lëvdì...nani...O i vetmi Bir....

## **Ant. III**

Gjegjeni këtò, o ju të gjithë pòpujitë; mirrëni veshë, o  
ju të gjithë, çë jesni në jetë.

## **Apol.**

U ngrëjite në lëvdì, o Krisht Perëndia jinë, edhë gëzove  
dsënësit me të taksurën e Shpirtit Shejt, tue i  
vërtetuar me bekimin, se Ti je i Biri i Perëndis,  
Shpërbimitari i jetës.

## **Isodikon**

U ngjip Perëndia ndër thirma gjëzimi; in'Zot ndër të rar  
trumbetie. Shpëtona, o i Biri i Perëndis, çë ngak na u  
ngjipe në kjiell me lëvdì, neve çë të këndojojm Allilùia.

## **Kont.**

Kur për gjithë ne mbarove urdhurimin e përbashkove

dheun me kjielliën, u ngjipe në lëvdì, o Krisht Perëndia jinë, pa u ndar mosgjakùn ngak na, po tue kjëndruar i pandarshëm, e tue thënë atireve çë të duan mirë: U jam bashkë me ju, e mosnjeri isht kundra jush.

### Megalinarion

Tij, çë me viersh i pandëlgashëm u bëre Mëma e t'in Zoti e çë linde në mot të pamotshmin, na të besmë gjithënjeibashku madhërojëm.

### Kjinonikon

U ngjip Perëndia ndër thirma gëzimi; in'Zot ndër të rartumbetie. Allilùia.

### Opistavon

O i Madh ' in ' Zot, ngrë mendimet t' anë ndaj Kjielliës, neve çë i përmisemi Fukjis t'ende, e nga përkujdeset e dheut rrnarë mendien t'enë tek Ti, çë naturën t'enë të përujme e ngrëjte tek Ti, dhe e bëre të ujej tek e Drejta e të Lartit At. E bënnë të mirë" sa na, çë nanë jemi tejeta, të rrojëm si kurse jemi në kjiell tue kërkuar vetëm të sipërmjet tekù Ti je ujur te ana e drejtë të Perëndis, e të presiën të jardhurit t'atë pameta të lëvduashëm e të dreruashëm, si Ti për anë të Engjëjëvet i the të lumëvet Apostoj, çë të panë të ngjipeshe në kjiell.

E vurna bashkë te numeri të atireve, çë në për mjekullavet ka të vijën të të përpikëjen Tij kur të vishë të gjëkosh jetën në drejtësi, sa bashkë me atà përgjithëmonë të gëzonemi tue trazhguar ëmbëlsin t'ende me pëlqimin e mirësin të Atit t'ënt të pa zënë fill, me të cilin Ti je i bekuar e i lëvduar bashkë me gjithë Shejtin, i mirë e çë jep gjellë Shpirt t'ënt, nanë e përgjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin!

## Apolisis

Ai çë u hip në lëvdi te kjiellia e rri ujur te ana e drejtë  
të t'Jatit,Krishti...



## **TEK E DIELLIA E PENDEKOSTES**

### **Ant. I**

Kjielliat rrëfiejën lëvdin e Perëndis e kjëndresa dëftون  
punën e duarvet t'Tij.

Për parkalesitë... Lëvdì... nani...

### **Ant. II**

Të gjegjëshit in'Zot te dita e helmit e të ruashit embri i  
Perëndis s'Jakobit.

Shpëtona, o Ngushëllimtar i mirë, neve çë të këndojojmë  
Allilùia.

Lëvdì... nani... O i vetmi Bir...

### **Ant. III**

O i madh'in'Zot, Rregji do t'gëzonet te fukjia jote; harë  
të madhë do t'ket te shëndetia jote.

### **Apol.**

I bekuar je, o Krisht Perëndia jinë, Ti çë të dishmë  
pishkëtarët dëftove, tue dërguar mbi atà Shpirtin Shejt  
e me atà gjithë jetën zure në rrietë. O ti çë do mirë  
njerëzitë, lëvdì Tij.

### **Isodikon**

Lartësou, o i madh'in Zot, me pushtetin t'ënt. Na do  
t'këndojojmë e të msaliëm fukjët t'ote. Shpëtona, o  
Ngushëllimtar i mirë, neve çë të këndojojmë Allilùia.

## Kont.

Kur i Larti u sdrip e përzjejti gluhest, ndajti gjindet; kur dhuroi gluhest ziarri, i thërriti të gjithë në bashkim e na gjithënjëzë lëvdojëm gjithëshejtin Shpirt.

## Trisajon

Oh sa në Krisht u pagzuat, me Krishtin u veshët.  
Allilùia.

## Megal.

Ti çë pa njohur burrë zure në gji e çë i dhe mishë  
Fialës çë bëri gjërkjishë, o Mëm'e pangar, o Virgjërë  
Mëmë të Perëndis, vent të të Pasosmit, Arkë të  
t'Madhit Stisor t'ënt, Tij na madhërojëm.

## Kjinonikon

Shpirti jit i mirë ka të më helkjënë te dhromi i drejt.  
Allilùia.

## Opistavon

O Zoti Krisht, Ti çë deshe se pas pesimevet t'atë e të  
ngjallurit, të hipeshe te kjielliat, çë Ti uje sa të leheshe  
për ne nga Virgjëra, nani Ti sdripe sa të vërtetoshë të  
taksurën t'ënde në dhet, tue frimëzuar Shpirtin Shejt  
Dsënësvet t'atë, sa të rrijturit e'Tij të shejtë të  
patundëshëm ndë'atà e pr'anë t' t'ire ndë'atà çë tek Ti  
kanë besë të mfortësonjë Klishën me dhuretit të  
mëdhà të'Tij.

Mos llargò ngak na Hirin e'Tij, përcë jemi të varruarë  
nga mëkata, pò jip mortë çëdo mendimi mishi çë ë ndë  
ne e çë ndalòn të jardhurit e 'Tij ndë ne.

Përzë ngak na çëdò të menduar, të folë, të bërë, çë e

dishpëlkkjen e çëdò dishirim të ndyemë çë trazon dhe errëson shpirrat t'anë me të u lipsurit Drita e Tij.

Benna putçërë të dëlirë të lëvdis s'Tij tue i glarë Sionit të sipërmë të plotë me dritën e Tij.

Bën-na thronë të ziarrit t'Tij shpirtullor, neve çë kërkojmë t'i glasiëm Apostojvet çë të pritën të parën herë sa na, të mfortësuarë nga Aì, të jemi drejtëruarë nga Aì ndaj dheut e të pavdekëshmes dhe e lume të taksurë, tekù isht vendi i gjithë atireve çë të trashgojën e pa u lodhurë të' lëvdojën.

Përçë Ti je i lëvdushëm bashkë me të pazënин At e me gjithë shejtin e gjellëdhënës Shpirt, nanë e përgjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Amin.

### **Apolisis**

Ai çë dërgoi nga kjiellia në pamie gluhe ziarri Shpirtin Shejt mbi dzënsit e Apostojit e' Tij të shejt, Krishti Perëndia...

### **Apolisis del Vespro**

Ai çë përuji Vetëhen e 'Tij e çë dolli nga gjiri i Atit e Perëndi, e çë u sdrip mbi dhe nga kjiellia e çë mori gjithë naturën t'enë dhe e shejtëroi, e çë pastaj, si u ngjip pameta te kjiellia dhe u ujë' te ana e drejt të t'Jatit e Perëndi, dërgoi Shpirtin Shejt, gjithë një i klënëshëm, gjithë një i fukjishëm, gjithë një i lëvduashëm, gjithë një i pasosmë, mbi Dsënësit dhe Apostoj t'Tij, të shejt, dhe paj të Tji i dhà dritë atireve, e paj të Tire gjithë

jetës, KRISHTI Perëndia jinë i vërtetë, për parkalesitë e gjithë shejtes Mëmës s'Tij e pamëkatë, e paj të Shejtit Apostoj mnematoforë, të lëvduashëmë, të nderua-shëm e lajmëtarë të Perëndis, si edhë me parkalesitë të gjithë Shejtravet, na paçit lipisi e na shpëtofshit, si i mirë e çë njeriun do mirë.

Amin.